



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
http/www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues

Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 1354/005  
Dt 04.10.2017

Në bazë të nenit 38, lidhur me nenin 32, pika 2.1 të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 28.9.2017, mori:

**VENDIM**

- I. Prof. ass. dr. Rifat Morina i pezullohen të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë nga pozita e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë së UMIB-it.
- II. Prof. ass. dr. Rifat Morina i pezullohet shtesa nga pozita e e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë, duke përfshirë edhe të gjitha beneficionet që i kanë takuar në bazë të Rregullores për të ardhura personale të UMIB-it dhe akteve të tjera normative të Universitetit.
- III. Vendimi hyn në fuqi prej 1.10.2017.

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 23.6.2017, me propozim të rektorit (propozim ky i konstatuar nga Senati dhe dekanët e njësive akademike të UMIB-it) ka marrë vendim për shkarkimin e prof. ass. dr. Rifat Morina nga pozita e prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe zhvillim të cilësisë të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (vendimi nr. prot. 986/005 e datës 23.06.2017) dhe i ka rekomanduar Ministrin të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë marrjen e vendimit përfundimtar (shkresa për miratimin e vendimit drejtuar MASHT-it me nr. prot. 3194 e datës 27.06.2017).

Nga koha e dorëzimit në MASHT të këtij vendimi dhe pritjes së vendimit përfundimtar nga ky institucion kanë kaluar 3 muaj dhe gjatë kësaj periudhe i përmenduri është kompensuar dhe ka përfutur të gjitha beneficionet, në bazë të Rregullores për të ardhura personale të UMIB-it, për pozitën e prorektorit edhe pse nuk ka ushtruar asnjë detyrë. Gjithashtu, duke pasur parasysh se ka kaluar edhe afati i paraparë me nenin 32 pika 4 të Ligjit të procedurës administrative, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, në MASHT.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB – it,
2. MASHT-it,
3. Rektorit të Universitetit,
4. Sekretarit të Përgjithshëm,
5. Të përmendurit.



Dr. sc. Sabri Sadiku

*Sabri Sadiku*  
Kryesues i Këshillit Drejtues